



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:055078
Datë: 27.02.2024
Numri i dokumentit: 05380360

C.nr.1002/22

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtarja Edije Sezairi, me bashkëpunëtorin profesional B.G. në çështjen juridike kontestimore të paditësit M.I. nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqësojnë av. B.K. dhe av. F.G. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 577.20 euro, jashtë seancës gjyqësore, më datë **27.02.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. RFUZHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit M.I. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që: *“ Të detyrohet e paditura Komuna e Prizrenit – Drejtoria e Arsimit në Prizren që në emër të pagesës për kualifikim-licencim t’ia paguaj paditësit M.I. shumën prej 577.20 euro dhe atë për 8 muaj nga data 18.04.2017 e deri më datë 10.12.2017 me kamatë ligjore prej 8% nga dita e parashtrimt të padisë”*.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi M.I. nga Prizreni, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë av. B.K. dhe av. F.G. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, Prizren, me objekt të kontestit kompensimi i të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, vlera e kontestit 577.20 euro.

Në padi, pala paditëse ka theksuar se paditësi është i punësuar si mësimdhënës pranë Gjinnnazit “Gjon Buzuku” në Prizren. Tutje, ka theksuar se paditësi është i licencuar dhe i kualifikuar me shkollë të lartë pedagogjike, ku në bazë të nenit 7 të Kontratës Kolektive me nr. të protokollit 2056 të datës 18.04.2017 i është garantuar e drejta në pagesën shtesë prej 27 % të pagës bazë, ku paditësi në bazë të kontratës ka realizuar pagë bazë prej 442 euro, ndërsa shtesën prej 27% apo shumën prej 154.70 euro e paditura ia ka paguar paditësit pjesërisht dhe atë vetëm shumën prej 82.55 euro, duke mos ia paguar edhe shumën prej 72.15 euro, duke kërkuar nga gjykata që të detyroj të paditurën që paditësit të ia paguaj shumën prej 577.20 euro për 8 muaj nga data 18.04.2017 e deri më 10.12.2017. Gjithashtu ka shtuar se i janë drejtuar të paditurës me kërkesë të veçantë për realizimin e kësaj të drejte, mirëpo i njëjti nuk ia ka kthyer përgjigje, andaj i ka propozuar gjykatës që të marrë aktgjykim dhe ta aprovojë kërkesë padinë e paditësit si të bazuar, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

E paditura, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar, duke kërkuar që gjykata të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar. Ka theksuar se pretendimi i paditëses se i takon kompensimi për licencim është në kundërshtim me nenin 2 par. 1.1 të Kontratës Kolektive të Arsimit, sepse në atë dispozitë shkruan se përfitues të të gjitha beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm për anëtarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK-ut, ndërsa paditësja nuk ka paraqitur fakte se është anëtar i kësaj sindikate, nuk ka dëshmuar me anë të kartelës së anëtarësisë. Po ashtu ka theksuar se paditësja ka ushtruar padi në gjykatë për realizimin e të drejtave pa përfunduar procedura administrative, sepse nuk i ka vazhduar procedurat në Inspektoratin e Punës në Prizren, që do të thotë se paditësja nuk i ka shterur të gjitha mjetet juridike në procedurën administrative, ashtu që i janë drejtuar gjykatës në kundërshtim me nenin 124 par. 6.1. të Ligjit për Procedurën Administrative, dhe me këto veprime të paditurës i shkaktojnë shpenzime të mëdha, sepse obligohen të paguajnë edhe shpenzimet e procedurës gjyqësore. Sa i përket obligimit lidhur me përmbushjen e detyrimit, e paditura në përgjigjen në padi thekson se vet Komuna e Prizrenit nuk është nënshkruese e Kontratës Kolektive, përkatësisht Qeveria e Republikës së Kosovës është garantues i implementimeve të KKAK-së, andaj Komuna e Prizrenit nuk ka kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që burojnë nga KKAK-ja. E paditura ka kontestuar kërkesëpadinë duke u bazuar në LMD, duke deklaruar se paditësja ka humbur të drejtën për realizimin e kërkesës, pasi që ka kaluar afati 3 vjeçar, ashtu që ka arritur parashkrimi i kërkesës së paditëses. Me të gjitha të cekurat si më lartë, e paditura ka kërkuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata ka vlerësuar provat si në vijim: Vërtetimin me numër të protokollit 733 të datës 15.06.2021, diplomën me numër 695 të datës 26.12.1980 si dhe listën e pagave të Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e pa bazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e refuzoi në tërësi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestues fakti se paditësi M.I. ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënës pranë Gjimnazit “Gjon Buzuku” në Prizren. Mirëpo, kontestuese ishte nëse paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, përkatësisht diferencës konkrete të paguar, si dhe nëse kërkesa e paditëses për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit është parashkruar.

Pas shqyrtimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe pas shqyrtimit të përgjigjes në padi, gjykata e vlerësoi të bazuar pretendimin e palës së paditur lidhur me parashkrimin e kërkesës së palës paditëse. Kështu, sipas nenit 87 të LP-së shprehimisht theksohet që “të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”. Në këtë drejtim, paditësja padinë pranë kësaj gjykate e ka parashtruar më datë 23.03.2022, ndërsa kërkesa e paditësit ka qenë për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit ose licencimit për 8 muaj 18.04.2017 e deri më datë 10.12.2017 (deri në datën e pensionimit të paditësit). Kështu, duke e vlerësuar afatin 3 vjeçar për parashkrimin e kërkesës në fjalë, gjykata erdhi në përfundim se paditësit iu ka parashkruar e gjithë kërkesa për kompensim në emër të kualifikimit për periudhën 18.04.2017 deri me datë

10.12.2017, sepse padia është paraqitur me datë 23.03.2022 dhe sipas llogaritjes së gjykatës rezultoi se kërkesa është parashkruar dhe mbi këtë batë gjykata e refuzoi të pabazuar sikurse në pikën nën I të dispozitivit të aktgjykimit.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 399 par. 1 të LPK-së parashihet që “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadija”.

Lidhur me kundërshtimet tjera të palës së paditur dhënë në përgjigje në padi, gjykata vlerësoi se të njëjtat nuk janë të bazuara në dispozita ligjore dhe nuk kanë mbështetje në ndonjë bazë faktike apo juridike, përpos kundërshtimit për parashkrim të cilën gjykata e vlerësoi të bazuar dhe e sqaroi më lartë. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 450, 452 dhe 463 të LPK-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me nenin 143 lidhur me nenin 399 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil
C.nr.1002/22, më datë 27.02.2024

Gjyqtarja
Edije Sezairi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi të të njëjtit, pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore.